




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. Z-D/DPK	Br Prot. 01-4896/15
Dep.	Prot No
Nr. i faq.	Data
Broj stranica 02	Datum 22.12.2015
Nr. pages	Date
	PRISTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4189-15, për Zyrtarin e lartë, z.Halil Mustafa - Kryeshef ekzekutiv në Ndërrmarrjen Publike "Trafiku Urban" në Prishtinë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4189-15, për Zyrtarin e lartë, z.Halil Mustafa-Kryeshef ekzekutiv në Ndërrmarrjen Publike "Trafiku Urban" në Prishtinë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Mustafa është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-4373/15), pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Mustafa është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell informatën mbi biznesin (DPK/DPKI-03-02-4859/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se te biznesi, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar "EAS" sh.p.k. z.Mustafa tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtoria Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni